

**METODOLOGJIA E PËRLLOGARITJES SË RIMBURSIMIT
TË DËMIT EKONOMIK NGA OPERATORI I SISTEMIT,
SI PASOJË E NDËRHYRJEVE TË PALIGJSHME
NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES**

PREAMBUL

Kjo metodologji hartohet në kushtet kur si rezultat i ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin shpërndarës, Operatorit të Sistemit i shkaktohen humbje në rrjetin e tij të shpërndarjes dhe Furnizuesi nuk mund të realizojë matjen e saktë të konsumit të energjisë elektrike në sistemin matës, gjë që mund të sjellë për pasojë, moslëshimin e faturës së saktë të energjisë elektrike.

Miratimi i Ligjit Nr.43/ 2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ka përcaktuar detyrimin ligjor të ndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili duhet të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera, të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike.

Humbjet teknike dhe jo teknike, sjellin një ndikim negativ në sistemin e shpërndarjes, sidomos për shkak të dëmtimeve që i shkaktohen rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe sistemit matës, në pikën e lidhjes midis kompanisë dhe konsumatorëve. Ndërhyrjet e paligjshme në rrjet, jo vetëm që shkaktojnë pasoja negative ekonomike për furnizuesin dhe operatorin e shpërndarjes, por njëkohësisht përbën një rrezik potencial për jetën dhe shëndetin e personave që me veprime aktive dhe abuzive, ndërhyjnë në sistem.

Gjithashtu, në këtë metodologji bëhet një ndarje e qartë midis pasaktësisë në matje, e cila rregullohet sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike, si dhe Kodit të Matjes, apo edhe kontratës së furnizimit me energji elektrike, përmes kompensimit.

Ndërkohë, miratimi i kësaj metodologjie, ka për qëllim të rregullojë procedurën e rimbursimit të Operatorit i sistemit, në rastet kur konstaton ndërhyrje të paligjshme, përmes ndjekjes së procedurës ligjore lidhur me përlllogaritjen e rimbursimit përkatës.

1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj Metodologjie është rregullimi i marrëdhënies midis furnizuesit, klientit dhe operatorit të shpërndarjes, lidhur me rimbursimet e humbjeve ndaj operatorit të sistemit, si pasojë e ndërhyrjeve në sistemin e shpërndarjes.

2. Objekti

Kjo Metodologji do të jetë e zbatueshme për rastet kur operatori i sistemit dhe/ose furnizuesi bazuar në përcaktimet ligjore duhet të rimbursohet, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin elektrik të operatorit të sistemit.

3. Baza Ligjore

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet kjo metodologji është Ligji Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Neni 68, Neni 76, Neni 77, Kodi Civil, Kodi Penal, Kodi i Shpërndarje, Kodi i Matjes, Kontrata e Furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jo familjarë, legjislacionit lidhur me administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, Modeli i Tregut dhe Metodologjia e Llogaritjes së Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Rregullorja e Cilësisë së Shërbimit.

AKRONIME DHE PERKUFIZIME

“**Furnizim**” është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

“**Furnizues Universal**” është një shoqëri e licensuar, e cila në përputhje me dispozitat e ligjit 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” furnizon me energji elektrike kategoritë e miratuara të klientëve, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me cmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese;

Operatori i Shpërndarjes ose OSSH është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë. Marrëdhënia ndërmjet Shpërndarësit dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, për efekt të kësaj kontrate, do të jetë subjekt i një marrëveshjeje të vecantë, ndërmjet palëve.

Klient është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

Klient familjar është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtar e apo profesionale.

Klient fundor është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak dhe plotëson kushtet ligjore dhe teknike për lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike;

Klient jofamiljar janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.

Klient i vogël jofamiljar është një person fizik apo juridik, i lidhur në nivel tensioni 0,4 kV, i cili blen energji për përdorim në mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij dhe jo për qëllim rishitjeje.

Klient shumice është një person fizik ose juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitje brenda ose jashtë sistemit të vendit ku është regjistruar.

Klient në nevojë është një klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruar në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji

Matje – është energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e furnizuar te klientët fundorë e cila matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e Kodeve të Rrjetit dhe Kodin e Matjes, si dhe në legjislacionin në fuqi për metrologjinë.

Mates Kontrolli

Matesi i Kontrollit quhet matesi i autorizuar dhe i çertifikuar për kontrollin e matjes në raste kur ka mosmarrëveshje midis Paleve për tregimet e matjes të matesit të vendosur në objekt, ose në rastin e kontroleve rutine të programuar të matesave.

Perputhja e matjes

Përputhja e matjes nënkupton krahasimin e vlerës të energjisë të regjistruar në mates me vlerën e energjisë totale të kërkuar (e regjistruar në distance).

Sistemi i Matjes së Energjisë Elektrike

Sistemi i Matjes kupton tërësinë e pajisjeve të matjes: matesin, automatën, transformatorët e matjes, mbrojtjen e matesit dhe izolatorët, qarqet dhe paisjet e ruajtjes të të dhenave, paisjet e transmetimit dhe komunikimit të të dhenave dhe lidhjet e nevojshme kabllorë të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të Energjisë Elektrike aktive dhe Energjisë Elektrike reaktive në objekt.

Lexim matësi – është procesi i regjistrimit të të dhënave të matjes për çdo Klient Fundor

Faturim- është procesi i regjistrimit të konsumeve të faturueshme për çdo klient Fundor

Konsum i faturueshëm- është sasia në këh e faturueshme nga Furnizuesi për klientin

Ambient në bashkëpronësi të çdo pronari të njërive të veçanta- shkallët, muret ndarëse të brendshme, ashensorët, pompat e ujit, gjeneratorët, taraca, oxhaqet, instalimet e brendshme deri në njësitë e ndara/veçanta, kanalizime, kolona shkarkimi, oxhakë, sisteme elektrike, hidraulike, gazi ose ngrohjeje, që mund të kalojnë nëpër pronën e përbashkët deri në pikat e shpërndarjes në njësitë individuale, si dhe cdo objekt tjetër i destinuar për përdorim të përbashkët nga pronarët e njërive të veçanta.

Kerkesa Maksimale per Energji Elektrike

Kerkesa maksimale është vlera më e lartë e kërkesës së regjistruar në një kohë të caktuar për të percaktuar tarifat ose për qëllime të tjera.

Periudha e marreveshjes

Periudha e marreveshjes kupton kohën gjatë të cilës përmbushen vlerat kontraktuale të Energjisë Elektrike sipas marreveshjes tregëtare midis personave apo Paleve. Kjo periudhë është një vlerë e plotë e kohës të kërkesës për Energji Elektrike.

Rryma e matjes

Rryma e matjes kupton rrymën e lejuar të matësit të përdorur me qëllim matje.

Rregjistruues lokal

Rregjistruuesi lokal kupton një pajisje shoqëruese, rregjistruese dhe memorizuese të aparatit matës ose një kompjuter portativ, që mund të marrë të dhënat e matjes së energjisë elektrike aktive, reaktive (si dhe të dhëna të tjera), t'i ruajë ato dhe t'i riprodhojë në një vend dhe në një kohë tjetër.

Sistemi i të dhënave

Sistemi i të dhënave kupton një sistem të integruar që mbledh dhe merr të dhënat prej pajisjeve të matjes (matësit) mbi bazën e një teknologjie të caktuar komunikimi dhe programi aplikativ.

Sistemi i shpërndarjes

Sistemi i shpërndarjes përfshin zbarat, celsat dhe pajisjet transformuese në nën-stacionet 110/35/20/10 kV, dhe të gjithë elementet në nivelin 110 kV të zotëruara nga OSSH.

Sistemi i Regjistrimit të Matësit

Sistemi i Regjistrimit të Matësit (SRM) kupton një sistem, i cili identifikon matësin dhe konsumatorin që i takon dhe përmban të dhënat kryesore të matësit në përputhje me KME.

Verifikim

Verifikim do të thotë konfirmimi nëpërmjet ekzaminimeve dhe provave që kërkesat specifike teknike dhe metrologjike janë përmbushur.

Energjia Elektrike Aktive (Wh)

Energjia Elektrike është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, dhe percaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës.

Njësia matëse e saj është Vat-Ore ose shumefisha të saj:

1000Wh=1kWh

1000kWh=1MWh

1000MWh=1GWh

1000GWh=1TWh=10¹²Wh

Energjia Elektrike Reaktive (VArh)

Energjia Elektrike reaktive eshte integrali i caktuar me kufije kohe i Fuqise reaktive matur ne njesi me volt-am per reaktive-ore ose shumefisha te saj.

$$1000 \text{ VArh} = 1 \text{ kVArh}$$

$$1000 \text{ kVArh} = 1 \text{ MVArh}$$

$$1000 \text{ MVArh} = 1 \text{ GVArh}$$

$$1000 \text{ GVArh} = 1 \text{ TVArh} = 10^{12} \text{ Varh}$$

Fuqia Elektrike Reaktive (VAr)

Fuqia Elektrike Reaktive eshte produkti i tensionit dhe rrymes dhe sinusit te kendit te fazes ndermjet tyre. $Q = (U \times I) \times \sin\phi$, matet me njesine volt-amper reaktiv(VAr) dhe shumezime standarte

$$1000 \text{ VAr} = 1 \text{ kVAr}$$

$$1000 \text{ kVAr} = 1 \text{ MVAr}$$

$$1000 \text{ MVAr} = 1 \text{ GVAr}$$

$$1000 \text{ GVAr} = 1 \text{ TVAr} = 10^{12} \text{ Var}$$

Fuqia Elektrike Aktive (W)

Fuqia Elektrike eshte produkti i tensionit dhe rrymes dhe kosinusit te kendit ndermjet tyre. $P = (U \times I) \times \cos\phi$
Matet me njesine Vat (W) ose shumezime standarte:

$$1000 \text{ W} = 1 \text{ kW}$$

$$1000 \text{ kW} = 1 \text{ MW}$$

$$1000 \text{ MW} = 1 \text{ GW}$$

$$1000 \text{ GW} = 1 \text{ TW} = 10^{12}$$

4. PËRGJEGJËSITË E OPERATORIT TË SISTEMIT

4.1 Referuar legjislacionit në Sektorin e Energjisë,

1. Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në Ligjin Nr.43/2105, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për:
 - a) sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;
 - b) përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,
 - c) mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar.
4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ofron pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes respekton treguesit e cilësisë së shërbimit dhe kërkesat e parashikuara nga rregulloret teknike.
5. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike zhvillohet mbi parimin e kostos më të ulët, në përputhje me legjislacionin mbi planifikimin urban, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe përdorimin me eficiencë të energjisë.
6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve teknologjike. Në varësi të mundësive, pjesë të infrastrukturës së komunikimeve dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e veta brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.

4.2 Detyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:

- a) operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm;
- b) zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe parashikimet e kërkesës për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- c) lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët dhe/ose prodhuesit, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi;
- ç) siguron akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

4.3 Në mbështetje të këtyre përgjegjësive ligjore operatori i sistemit:

- a) Ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit përkatës lidhur me administrimin dhe përdorimin e energjisë elektrike;
- b) Ushtron kontroll për mbrojtjen e rrjetit elektrik dhe të elementeve të tij nga ndërhyrjet e dëmtimet si pasojë e punimeve të kryera nga persona fizikë e juridikë, vendas e të huaj pa miratimin e organeve përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- c) ndjek procedurën për lidhjet e reja, për dokumentacionin teknik dhe zbatimin e tij;
- ç) Kontrollon sistemin matës të energjisë elektrike sa herë e gjykon të nevojshme;
- dh) Hyn në objekt (banesë), me pëlqimin dhe në prani të përdoruesit të energjisë elektrike, ose kur është rasti me vendim gjykate, për të siguruar/kontrolluar mirëfunksionimin e sistemit të shpërndarjes;
- ë) Hyn në çdo kohë në ndërmarrje, institucione, lokale ose vende të tjera, ku ushtrojnë veprimtarinë personat juridikë për të siguruar/kontrolluar mirëfunksionimin e sistemit të shpërndarjes;
- dh) Hyrja e punonjësve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në objekte të rëndësisë së veçantë, bëhet me autorizim.

Kur gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësi i autorizuar për kontrollin e sistemit të shpërndarjes, konstaton ndërhyrje në sistem ka përgjegjësinë për raportimin e këtyre rasteve tek strukturat eprorë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

Operatori i Shpërndarjes kur vëren shkelje të legjislacionit përkatës, si dhe ato që lidhen me këtë metodologji, nga punonjësit e strukturave që merren drejtpërdrejt me administrimin e energjisë elektrike, merr masa administrative në proporcion me shkeljen e konstatuar.

5. PËRGJËGJËSITË E FURNIZUESIT

- 5.1 Furnizuesi ka detyrimin e furnizimit me energji elektrike të Klientit sipas kategorive të përcaktuara, në përputhje me legjislacionit në fuqi dhe kushtet e kontrates së furnizimit me energji elektrike;
- 5.2 Furnizuesi (sipas marrëveshjes me Operatorin e Shpërndarjes), ka të drejtë të rimburohet nga Klienti Fundor, për shkak të ndërhyrjeve të paautorizuara në rrjet;
- 5.3 Furnizuesi ka të drejtë që krahas rimbursimit të demit për shkak të ndërhyrjeve të paautorizuara në rrjet, të ndjekë penalisht shkelësit e ligjit;
- 5.4 Furnizuesi ka të drejtë të kërkojë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore, si dhe rilidhjen e energjisë elektrike, kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit.

6. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KLIENTIT

6.1. Klienti ndër të tjera, ka këto të drejta:

- a) të furnizohet me energji elektrike në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e furnizimit me energji elektrike;
- b) të marrë informacion të plotë për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde, në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;
- c) të informohet, për konsumin dhe kostot respektive të energjisë elektrike, pa kosto shtesë;
- d) të kërkojë tek Furnizuesi instalimin e njësisë matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tij;

6.2 Klienti ndër të tjera, ka këto detyrime:

- a) të përdorë energjinë elektrike vetëm në përputhje me këtë kontratë;
- b) të paguajë për energjinë elektrike me një nga mundësitë që Furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet pagesës së drejtpërdrejtë në Zyrat e Furnizuesit, bankave, zyra postare, kanaleve alternative të pagesave apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare), në përputhje me kushtet e kontratës;
- c) të ruajë personalisht ose përmes përfaqësuesit të administrimit të bashkëpronësisë, sistemin dhe pajisjet matëse të energjisë elektrike brenda kufijve të pronës së tij;
- d) t'i mundësojë instalimin, mirëmbajtjen, aksesin e lirë dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të energjisë elektrike (kur matësi është apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronës së tij).
- e) të respektojë kushtet e kontratës së furnizimit;
- f) të ruajë personalisht ose përmes përfaqësuesit të administrimit të bashkëpronësisë, sistemin dhe pajisjet matëse të energjisë elektrike brenda kufijve të pronës së tij;

7. Përcaktimi i masës së rimbursimit të konsumit të energjisë

Masa e rimbursimit të konsumit është vlera referuese e energjisë elektrike, e kërkueshme nga Furnizuesi ndaj klientit:

- a) vlera në kWh e cila do të përfshihet në faturën e konsumit të Energjisë Elektrike, bazuar në :
- Vlerës reference zëvendësuese, në varësi të kategorisë së klientit me konsum maksimal për secilën kategori sipas tabelave vijuese.
 - Afati kohor i aplikimit të vlerës referuese për rimbursim nga Furnizuesi do të realizohet bazuar në përcaktimet e kontratës të furnizimit me energji elektrike

Tabela 1: Konsumi Maksimal per Kategorine Familjar

Familjar	Pinst kw	Sasia kWh	Sasia Maksimale kWh
1 Fazor	3 deri 5	750	750
3 Fazor	6 deri 10	900 -1500	1500
	10 deri 20	1500 - 3000	3000
	20 deri 40	3000 - 6000	6000

Llogaritur: Sasia këh = Pinst * 10 ore * 30 dite* 0.5 koef shfrytëzimi

Tabela 2: Konsumi Maksimal per Kategorine JoFamiljar për profile nën 50kw

JoFamiljar	Pinst kW	Sasia kWh	Sasia Maksimale KWh
1 Fazor	1 deri 5	1200	1200
3 Fazor	6 deri 10	1500 - 2500	2500
	10 deri 20	2500 - 5000	5000
	20 deri 50	5000 - 12000	12000

Llogaritur: Sasia kwh = Pinst*10 ore * 30 dite * 0.8 koef shfrytëzimi

Keto llogaritje nuk kane ndarje sezonale dimer –vere.

- **Profilet e ngarkeses mbi 50 kw,**

Për profilet e ngarkesës mbi 50kw masa e rimbursimit e kërkueshme nga Furnizuesi sa paraqitur ne tabelen me poshte.

Tabela 3: Permbledhje e Konsumit Maksimal i kërkueshem nga Furnizuesi

Nr.	Pershkrimi i objektit/ shpenzimeve	Njesia	Kategoria e Klientit	Pinst kW	Sasia kWh	Sekcioni kabllit mm2	In e Automati i	Konsumi Maksimal Referues Kwh (1)
1	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	750
1	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	750
2	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	6 deri 10	900 -1500	4x4	deri 16 A	1,500
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	3,000
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	6,000
2	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	6 deri 10	900 -1500	4x4	deri 16 A	1,500
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	3,000
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	6,000
2	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	1,200
2	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	1,200
4	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	2,500
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	5,000
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	12,000
4	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	2,500
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	5,000
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	12,000
5	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 100/5A	cope	Jofamiljar	51-74	17800		deri 100A	17,800
6	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 150/5A	cope	Jofamiljar	75-99	23800		deri 150A	23,800
7	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 200/5A	cope	Jofamiljar	100-124	29800		deri 200 A	29,800
8	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 250/5A	cope	Jofamiljar	125-150	36000		deri 250 A	36,000
9	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 300/5A	cope	Jofamiljar	151-174	41800		deri 300 A	41,800
10	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 400/5A	cope	Jofamiljar	175-200	48000		deri 400 A	48,000
11	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 500/5A	cope	Jofamiljar	201-225	54000		deri 500 A	54,000
12	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 600/5A	cope	Jofamiljar	226-300	72000		deri 600A	72,000
13	Mates 3-fazor ne Panel Matje ne T.M.	cope	Jofamiljar		mbi 72 mije kwh			sipas rastit

b) Llogaritja e Vlerës në Lekë

Vlera në lekë që do të aplikohen për këto sasi të llogaritura rimbursimi do të përlllogaritet bazuar në çmimet e aplikuar të shitjes të miratura nga ERE.

8. Përcaktimi i masës së rimbursimit të dëmit ekonomik nga Operatori i Sistemit për humbjet e shkaktuara në sistemin e shpërndarjes

Masa e rimbursimit të dëmit ekonomik për humbjet e shkaktuara në sistemin e shpërndarjes, është vlera referuese e energjisë elektrike, e kërkueshme nga Operatori i Sistemit (përmes Furnizuesit) ndaj klientit, e cila do të përfshihet në faturën e konsumit të Energjisë Elektrike bazuar në:

i) Përcaktimi i sasise kwh për vlerat referuese të kërkueshme nga Operatori i Sistemit për rimbursim në kushtet e mungesës së disponibilitetit të të dhënave të sistemit të matjes paraqitet bazuar në nënndarjen sipas kategorive vijuese dhe llogaritur mbi profile të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh dhe në formulën përlllogaritëse e cila merr në konsideratë:

- Rimbursimi i dëmit ekonomik për humbjet e shkaktuara në sistemin e shpërndarjes, do të kufizohet për periudhën e fundit **1 muaj**;
- Në rastin kur evidentohen dëmtime të sistemit të matjes, atëherë konsumatori është i detyruar të paguajë vlerën e mbetur për të paktën **1 muaj**;
- Vlera do të përfshihet në faturën e furnizimit dhe do të kërkohet nga Furnizuesi për Operatorin e Sistemit dhe do të jëtë e pagueshme bazuar në kushtet e kontratës së furnizimit.

ii) vlera në kwh e cila do të përfshihet në faturën e konsumit të Energjisë Elektrike do të jete vlera reference zëvendësuese, në varësi të kategorisë së klientit bazuar në treguesit:

- *Konsum maksimal sipas klientit për secilën kategori;*
- *Fuqisë së instaluar.*
- *Tërësinë e Nivelit të Humbjeve Joteknike të Energjisë bazuar në bilancin e energjisë*

Formula llogaritëse= (Sasia Këh/ muaj *1 muaj)/(1- niveli i humbjeve joteknike xx%) –Sasia e energjise Kwh konsum maksimal

Tabela 4: Tabela e Rimbursimit te Humbjeve Sipas profilit te ngarkeses

Nr.	Pershkrimi i objektit/ shpenzimeve	Njesia	Kategoria e Klientit	Pinst kW	Sasia kWh	Seksioni kabllit mm2	In e Automati	Muaj e References (2)	Sasia 1 mujore Kwh (3=1*2)	Niveli i Humbjeve Joteknike (4)	Energjia e Kerkueshme per Rimbursim Kwh (5=((3/(100%-4)-1)
1	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	1	750	10.57%	89
1	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	1	750	10.57%	89
2	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	6 deri 10	900 -1500	4x4	deri 16 A	1	1,500	10.57%	177
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	1	3,000	10.57%	355
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	1	6,000	10.57%	709
2	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	6 deri 10	900 -1500	4x4	deri 16 A	1	1,500	10.57%	177
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	1	3,000	10.57%	355
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	1	6,000	10.57%	709
2	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	1	1,200	10.57%	142
2	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	1	1,200	10.57%	142
4	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	1	2,500	10.57%	295
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	1	5,000	10.57%	591
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	1	12,000	10.57%	1,418
4	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	1	2,500	10.57%	295
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	1	5,000	10.57%	591
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	1	12,000	10.57%	1,418
5	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 100/5A	cope	Jofamiljar	51-74	17800		deri 100A	1	17,800	10.57%	2,104
6	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 150/5A	cope	Jofamiljar	75-99	23800		deri 150A	1	23,800	10.57%	2,813
7	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 200/5A	cope	Jofamiljar	100-124	29800		deri 200 A	1	29,800	10.57%	3,522
8	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 250/5A	cope	Jofamiljar	125-150	36000		deri 250 A	1	36,000	10.57%	4,255
9	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 300/5A	cope	Jofamiljar	151-174	41800		deri 300 A	1	41,800	10.57%	4,940
10	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 400/5A	cope	Jofamiljar	175-200	48000		deri 400 A	1	48,000	10.57%	5,673
11	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 500/5A	cope	Jofamiljar	201-225	54000		deri 500 A	1	54,000	10.57%	6,382
12	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 600/5A	cope	Jofamiljar	226-300	72000		deri 600A	1	72,000	10.57%	8,510
13	Mates 3-fazor ne Panel Matje ne T.M.	cope	Jofamiljar		mbi 72 mije kwh			1	sipas rastit	10.57%	sipas rastit

iii) Llogaritja e Vlerës në Lekë

Vlera në lekë që do të aplikohen për këto sasi të llogaritura rimbursimit do të përlllogaritet bazuar në çmimet e aplikuar të shitjes të miratura nga ERE.

9. Përcaktimi i masës së rimbursimit të Kostove të demontim/montim i matësit të dëmtuar

Masa e rimbursimit të kostove të demontim/montim matësit të dëmtuar, e kërkueshme nga Operatori i Sistemit (përmes Furnizuesit) ndaj klientit, e cila do të përfshihet në faturën e konsumit të Energjisë Elektrike bazuar në:

- i) **Përcaktimin e kostove të demontim/montim sistemit të matjes për vlerat referuese të kërkueshme nga Operatori i Sistemit për rimbursim në kushtet e dëmtimit të sistemit të matjes, bazuar në nënndarjen sipas kategorive vijuese dhe llogaritur mbi profile të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh :**

Përlllogaritja e vlerave referuese (pa përfshirë TVSH) paraqitet si vijon:

Tabela 5: Tabela e Rimbursimit te Demontim/Montim Matesit sipas profilit te ngarkeses:

Nr.	Pershkrimi i objektit/ shpenzimeve	Njesia	Kategoria e Klientit	Pinst kW	Sasia kWh	Seksioni kabllit mm2	In e Automati i	Shpenzime vendosje [leke/njesi]	Shpenzime demontimi [leke/njesi]	Shpenzime blerje matesi [leke/njesi]	Sherbimi i verifikimit te matesit ne laborator [leke/njesi]	Shpenzime materiale (tel;vula; kancelerie) [leke/njesi]	Shpenzime trajnimi personeli [leke/njesi]	Total [leke/njesi]
1	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	15,160	2,100	5,000	1,056	100	250	23,666
1	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	7,100	2,255	5,000	1,056	50	250	15,711
2	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	6 deri 10	900 -1500	4x4	deri 16 A	33,490	2,255	7,000	1,268	100	250	44,363
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	33,490	2,255	7,000	1,268	100	250	44,363
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	33,490	2,255	7,000	1,268	100	250	44,363
2	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	6 deri 10	900 -1500	4x4	deri 16 A	7,100	2,255	5,000	1,056	50	250	15,711
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	7,100	2,255	5,000	1,056	50	250	15,711
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	7,100	2,255	5,000	1,056	50	250	15,711
2	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	15,160	2,100	5,000	1,056	100	250	23,666
2	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	7,100	2,255	5,000	1,056	50	250	15,711
4	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	33,490	2,255	7,000	1,268	50	250	44,313
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	33,490	2,255	7,000	1,268	50	250	44,313
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	33,490	2,255	7,000	1,268	50	250	44,313
4	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	7,100	2,255	7,000	1,268	50	250	17,923
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	7,100	2,255	7,000	1,268	50	250	17,923
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	7,100	2,255	7,000	1,268	50	250	17,923
5	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 100/5A	cope	Jofamiljar	51-74	17800		deri 100A	65,000	13,000	7,500	1,268	150	250	87,168
6	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 150/5A	cope	Jofamiljar	75-99	23800		deri 150A	65,000	13,000	7,500	1,268	150	250	87,168
7	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 200/5A	cope	Jofamiljar	100-124	29800		deri 200 A	73,000	14,600	7,500	1,268	150	250	96,768
8	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 250/5A	cope	Jofamiljar	125-150	36000		deri 250 A	103,000	20,600	7,500	1,268	150	250	132,768
9	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 300/5A	cope	Jofamiljar	151-174	41800		deri 300 A	103,000	20,600	7,500	1,268	150	250	132,768
10	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 400/5A	cope	Jofamiljar	175-200	48000		deri 400 A	153,000	30,600	7,500	1,268	150	250	192,768
11	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 500/5A	cope	Jofamiljar	201-225	54000		deri 500 A	153,000	30,600	7,500	1,268	150	250	192,768
12	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 600/5A	cope	Jofamiljar	226-300	72000		deri 600A	165,000	33,000	7,500	1,268	150	250	207,168
13	Mates 3-fazor ne Panel Matje ne T.M.	cope	Jofamiljar		mbi 72 mije kwh			34,000	6,800	7,500	1,268	150	250	49,968

10. Arkëtimi i vlerës së rimbursimit

Furnizuesi me marrëveshje të përbashkët me Operatorin e Shpërndarjes arkëton në llogarinë e këtij të fundit pagesën e vlerës së rimbursimit, të kryer nga klienti që ka dëmtuar rrjetin e Shpërndarjes. Për këtë transaksion Furnizuesi vepron njësoj si një agjent tatimor i Operatorit të Shpërndarjes. Komisioni i shërbimit të arketimit të vlerës së rimbursimit, do të përcaktohet në marrëveshjen mes palëve, dhe do të llogaritet në përqindje (%) së vlerës së arkëtuar të rimbursimit. Bazuar në tabelën e çmimeve aktuale të energjisë vlera e arkëtueshme e kërkueshme nga Furnizuesi paraqitet në tabelën vijuese.

Tabela 6: Tabela e Vlerës së Rimbursimit totale të kërkuar sipas profilit të ngarkesës

Nr.	Pershkrimi i objektit/ shpenzimeve	Njesia	Kategoria e Klientit	Pinst kW	Sasia kWh	Seksioni kabllit mm2	In e Automati	Total Demontim/Montim Matesi [leke/njesi]	Konsumi Maksimal Referues Kwh (1)	Kufiri Maksimal Konsumit Vlera lek 1 (pa TVSH)	Sasia 1 mujore Kwh (3=1*2)	Energjia e Kerkueshme per Rimbursim Kwh (5=(3/100% -	Vlera lek energjia e Kerkueshme per Rimburs (pa TVSH)	Vlera TOTALE lek (pa TVSH)	Cmimi LEK pa TVSH (7)
1	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	23,666	750	7,125	750	89	842	31,633	9.5
1	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	3 deri 5	750	1x6+6	deri 25 A	15,711	750	7,125	750	89	842	23,678	9.5
2	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Familjar	6 deri 10	900 - 1500	4x4	deri 16 A	44,363	1,500	14,250	1,500	177	1,684	60,297	9.5
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	44,363	3,000	28,500	3,000	355	3,369	76,232	9.5
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	44,363	6,000	57,000	6,000	709	6,737	108,100	9.5
2	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Familjar	6 deri 10	900 - 1500	4x4	deri 16 A	15,711	1,500	14,250	1,500	177	1,684	31,645	9.5
			Familjar	10 deri 20	1500 - 3000	4x6	deri 32 A	15,711	3,000	28,500	3,000	355	3,369	47,580	9.5
			Familjar	20 deri 40	3000 - 6000	4x25	deri 63 A	15,711	6,000	57,000	6,000	709	6,737	79,448	9.5
2	Mates 1-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	23,666	1,200	16,800	1,200	142	1,986	42,452	14.0
2	Mates 1-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	1 deri 5	1200	1x6+6	deri 25 A	15,711	1,200	16,800	1,200	142	1,986	34,497	14.0
4	Mates 3-fazor ne Boks Individual	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	44,313	2,500	35,000	2,500	295	4,137	83,450	14.0
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	44,313	5,000	70,000	5,000	591	8,274	122,587	14.0
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	44,313	12,000	168,000	12,000	1,418	19,856	232,169	14.0
4	Mates 3-fazor ne Boks Kolektiv	cope	Jofamiljar	6 deri 10	1500 - 2500	4x4	deri 16 A	17,923	2,500	35,000	2,500	295	4,137	57,060	14.0
			Jofamiljar	10 deri 20	2500 - 5000	4x10	deri 32 A	17,923	5,000	70,000	5,000	591	8,274	96,197	14.0
			Jofamiljar	20 deri 50	5000 - 12000	4x25	deri 80 A	17,923	12,000	168,000	12,000	1,418	19,856	205,779	14.0
5	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 100/5A	cope	Jofamiljar	51-74	17800		deri 100A	87,168	17,800	249,200	17,800	2,104	29,454	365,822	14.0
6	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 150/5A	cope	Jofamiljar	75-99	23800		deri 150A	87,168	23,800	333,200	23,800	2,813	39,382	459,750	14.0
7	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 200/5A	cope	Jofamiljar	100-124	29800		deri 200 A	96,768	29,800	417,200	29,800	3,522	49,310	563,278	14.0
8	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 250/5A	cope	Jofamiljar	125-150	36000		deri 250 A	132,768	36,000	504,000	36,000	4,255	59,569	696,337	14.0
9	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 300/5A	cope	Jofamiljar	151-174	41800		deri 300 A	132,768	41,800	585,200	41,800	4,940	69,167	787,135	14.0
10	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 400/5A	cope	Jofamiljar	175-200	48000		deri 400 A	192,768	48,000	672,000	48,000	5,673	79,426	944,194	14.0
11	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 500/5A	cope	Jofamiljar	201-225	54000		deri 500 A	192,768	54,000	756,000	54,000	6,382	89,354	1,038,122	14.0
12	Mates 3-fazor ne panel matje me TRI 600/5A	cope	Jofamiljar	226-300	72000		deri 600A	207,168	72,000	1,008,000	72,000	8,510	119,139	1,334,307	14.0
13	Mates 3-fazor ne Panel Matje ne T.M.	cope	Jofamiljar		mbi 72 mije kwh			49,968	sipas rastit		sipas rastit	sipas rastit	sipas rastit		11.0

11. Procedurat që do të ndiqen gjatë konstatimit të ndërhyrjeve në Sistemin e Shpërndarjes

Operatori i Sistemit do të aplikojë këtë Metodologji, duke ndjekur procedurat e referuara në Aneksin Nr.1, bashkëlidhur, si pasojë e ndërhyrjeve në Sistemin e Shpërndarjes.

12. Hyrja në Fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi menjëherë.



Shpenzime per Matje
(3).xlsx

ANEKSI NR.1

Në zbatim të kësaj metodologjie, përfaqesuesit e Operatorit të Sistemit do të kryejnë kontrollin dhe verifikimin e rasteve të ndërhyrjeve, në Sistemin e Shpërndarjes, nga klientët familjarë dhe jo familjarë.

Kontrolli dhe verifikimi i këtyre rasteve do të shoqërohet me akte të posaçme, të miratuara nga Operatori i Sistemit.

Gjatë Procesit të verifikimit të klient hapat kryesore që duhet të realizohen përshkruhen në vijim:

Nr	Hapat	Njësia përgjegjëse
1.	Realizimi i Vizitës te Konsumatori	Ekipet
	a. Ekipi ose grupi operativ realizojnë vizitën të konsumatori bazuar në Planin i punës në formën autorizuar:	
	➤ Urdhër punë për vizitë te konsumatori – të bashkangjitet lista e konsumatorëve	
	➤ Urdhër punë për kontroll të sistemit të matjes – të bashkangjitet lista e konsumatorëve	
	➤ Urdhër punë të tjera –të bashkangjitet lista e konsumatorëve	
	b. njoftohet konsumatori duke e informuar për qëllimin e vizites/verifikimit	
	c. realizohet verifikimi bazuar në qëllimin e vizites	
	d. përpilohet PV konstatimit, shoqërohet me foto te matësit apo linjës në varësi të lidhjes dhe gjetjes	
	PV i Konstatimit është një dokument i unifikuar për gjithë OSHEE	
	➤ PV përmban numrin serial	
	➤ PV përmban Identifikimin e Agjensise dhe Dr Rajonale	
	➤ PV përmban datën e konstatimit	
	➤ PV përmban referencën e planit Nr Prot. Dt prot dhe urdhërit të punës Nr Urdhërit të punës Data e Urdherit të punës	
	➤ PV përmban Nr Kontratës, Emrin e Klienti, Kategorine e Klienti dhe identifikimin teknik të tij të lidhjes	
	➤ PV përmban të dhenat e sistemit të matjes	
	➤ PV përmban të dhenat e evidentuar në teren në lidhje me gjetjet specifike bazuar në objektin e puëns	
	➤ PV firmoset nga Grupi i Punes – ku identifikimi i anëtarëve të jëtë i qartë (emer mbiemer)	
	➤ PV firmoset për marrje njoftimi nga konsumatori	
	e. veprimet në rastet e evidentimit të parregullsive- në të cilat është e detyrueshme të njoftohen organet policore dhe realizohet denoncimi	
	i. vula e morseterise e cenuar	
	ii. vulat e makinerise e liruuar	
	iii. vulat e boxit te cenuara	
	iv. fuqia e instaluar e ndryshme nga ajo e evidentuar ne sistem	
	v. transformatoret e rrymes te cenuar	
	vi. demtime te jashtme te dukshme te matesit	
	vii. instalim i parregullt i matesi apo TRI -	
	viii. furnizim jashte matesit – lidhje e dyte e paautorizuar	
	ix. Rilidhje jo e autorizuar si pasoje e nderprerjes qe vjen nga statusi debitor	
	Në raste se evidentohen veprime qe kerkojne sistemimin e matjes atehere do të kërkohet perfshirja e Teknikëve të Laboratorit – për sistemin e matjes, duke njoftuar koordinatorin per nevojen emergjente.	
	f. njoftimi i konsumatorit për rezultatet e vizites	
	a. njoftohet konsumatori për rezultatin e kontrollit	
	b. i lihet kopje e PV të konstatimit	
	c. kopje e testimit të laboratorit nese eshte realizuar	
	Kopje e PV	

	g. evidentimi i efekteve apo veprimeve që influencojnë faturimin	
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ matesi rezulton i dëmtuar njoftohet klienti per efektet. rregjistrimi PV. <ul style="list-style-type: none"> ○ I lihet kopje PV të konstatimit - ○ Njoftohet për rezultatin e dhe i shpjegohet që së shpejti do të këtë një faturë shtese ne muajin pasardhës si rrjedhoje e dentimit të matësit ○ Instalohet matësi i ri 	
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dhënat e numrit të vulave (boxit/morseterise/makinerisë) nuk korrespondojnë më të dhënat në sistem <ul style="list-style-type: none"> ○ I lihet kopje PV të konstatimit për diferencat ○ I kërkohet nëse ka dokumentacion PV në lidhje me vizita më të hershme nga grupe pune , nëse po merret kopje e dokumentacionit ○ Nese jo Investigohet nga Agjensia brenda 24 arsytet e mospërputhjes ○ Nëse nuk ka informacion të njoftohen autoritetet përkatëse për realizimin e denoncimit përkatës 	
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të dhënat teknike nuk korrespondojnë më të dhënat në sistem <ul style="list-style-type: none"> ○ I lihet kopje PV të konstatimit për diferencat ○ I kërkohet nëse ka dokumentacion pagesë në lidhje ndryshimet nëse po merret kopje e dokumentacionit ○ Nese jo Investigohet nga Agjensia brenda 24 arsytet e mospërputhjes ○ Nëse nuk ka informaiconi bëhët azhornimi ○ Menaxhohet ndryshimi 	
	h. evidentimi dhe perlllogaritja e masës së rimbursimit	
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Aktet mbajtura dhe dokumentacioni shoqërues i siguruar gjatë kontrollit dhe verifikimit të rasteve të ndërhyrjeve n Sistemin e Shpërndarjes, dorëzohen pranë strukturave përgjegjëse, për veprime të mëtejshme lidhur me përlllogaritje e masës së rimbursimit, referuar rastit të ndërhyrjes dhe metodologjisë përkatëse. 	